



VENDIM

Nr. 176, Datë 07.11.2016

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “M.C
INERTE LUMZI” SH.P.K, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “d” të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” si dhe në zbatim të neneve 4, gërma “e”; 5, pika 1 gërma “e”; 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016; neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE Nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.11.2016, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për licensimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k, në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut;

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b”, “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat (“a”, “b”, “c”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b” “c”, “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Vërtetimin nga Gjykata dhe Prokuroria, (neni 9 pika 2 gërma “d”);

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b” dhe “c”), do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “M.C Inerte Lumzi” sh.p.k, në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI



Votimi i Bordit të ERE-s për,

VENDIM

Nr. 176, Datë 07.11.2016

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË “M.C
INERTE LUMZI” SH.P.K, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Anëtarët e Bordit

Pro

Kundër

Petrit Ahmeti

Adriatik Bego

Abaz Aliko

Entela Shehaj

Maksim Shuli
